

URDHËR
Nr. 406, datë 8.10.2020

**PËR MASAT PËR ULJEN E PREVALENCËS SË DISA SEROTIPAVE TË
SALMONELLA NË PULAT PËR PRODHIMTARI VEZËSH *GALLUS GALLUS***

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 16, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për masat për uljen e prevalencës së disa serotipave të *salmonella* në pulat për prodhimtari vezësh *gallus gallus*”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE

**PËR MASAT PËR ULJEN E PREVALENCËS SË DISA SEROTIPAVE TË *SALMONELLA*
NË PULAT PËR PRODHIMTARI VEZËSH *GALLUS GALLUS***

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

Masat referuar nenit 4, pika 1, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelozës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”, kanë për qëllim uljen e prevalencës të *Salmonella Enteritidis* dhe *Salmonella typhimurium* në pulat për prodhimtari vezësh *Gallus gallus* dhe arritjen e objektivave të mëposhtëm:

a) uljen e minimumit të përqindjes vjetore në tufat pozitive të pulave për prodhimtari vezësh të barabartë me:

- i. 10%, në rastin kur prevalenca në vitin e kaluar ka qenë më pak se 10%;
- ii. 20%, kur prevalenca në vitin e kaluar ka qenë më shumë se ose e barabartë me 10% dhe më pak se 20%;
- iii. 30%, kur prevalenca në vitin e kaluar ka qenë më shumë se ose e barabartë me 20% dhe më pak se 40%;
- iv. 40%, kur prevalenca në vitin e kaluar ka qenë më shumë se ose e barabartë me 40%; ose

b) uljen e përqindjes maksimale me 2% ose më pak, në tufat pozitive të pulave për prodhimtari vezësh. Për operatorët që kanë më pak se 50 tufa të pulave për prodhimtari vezësh, jo më shumë se një tufë pulash në prodhim, mund të mbetet pozitive.

Serotipat e *Salmonella Typhimurium* monofazike, me formulë antigjenike 1,4,[5],12:i:- përfshihen në objektivat për arritjen e qëllimit për uljen e prevalencës së salmonelave.

1. Skema e testimit për verifikimin e progresit të arritur jepet në shtojcën 1 (“Skema e testimit”).

Neni 2

Rishikimi i programit kombëtar

Objektivat rishikohen nga strukturat përgjegjëse për sigurinë ushqimore dhe shërbimin veterinar, duke marrë në konsideratë informacionin e mbledhur në përputhje me skemat e testimit dhe kriteret e përcaktuara në nenin 4, pika 6, shkronja “c”, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelozës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”.

Neni 3

Të gjitha dispozitat e rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelozës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”, në lidhje me *Salmonella Typhimurium*, përfshijnë, gjithashtu, shtamet monofazikë *Salmonella Typhimurium*, me një formulë antigjenike 1,4,[5],12:i:- .

Neni 4

Objekti kombëtar i referuar në nenin 4, pika 1, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelozës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”, për uljen e *Salmonella spp.* në tufat e mbarështimit *Gallus gallus*, do të konsistojë në zbritjen në 1% ose më pak, të përqindjes maksimale të tufave mature për mbarështim të *Gallus gallus*, të mbetura pozitive për *Salmonella Enteritidis*, *Salmonella Infantis*, *Salmonella Hadar*, *Salmonella Typhimurium*, përfshirë këtu shtamet *Salmonella Typhimurium* monofazikë, me formulë antigjenike 1,4,[5],12:i:-, dhe *Salmonella Virchow* (serotipat *Salmonella* përkatës).

SHTOJCË I

SKEMA E NEVOJSHME E TESTIMIT PËR VERIFIKIMIN E ARRITJEVE TË PROGRAMIT KOMBËTAR PËR ULJEN E *SALMONELLA ENTERITIDIS* DHE *SALMONELLA TYPHIMURIUM* NË PULAT PËR PRODHIMTARI VEZËSH *GALLUS GALLUS*

1. SKEMA E KAMPIONIMIT

Skema e kampionimit përfshin të gjitha tufat e pulave për prodhimtari vezësh të *Gallus gallus* (tufat mature), të përfshira në skemën e programit kombëtar të kontrollit të përcaktuar në nenin 5 të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”.

2. MONITORIMI I TUFAVE TË PULAVE PËR PRODHIMTARI VEZËSH

2.1 Frekuenca dhe statusi i marrjes së mostrave

Tufat e pulave për prodhimtari vezësh kampionohen në bazë të programit kombëtar të kontrollit, të hartuar nga struktura përgjegjëse për veterinarinë dhe me kërkesën e operatorëve të biznesit.

Kampionimi, me kërkesën e operatorëve të biznesit të ushqimit, bëhet të paktën çdo 15 javë. Kampionimi i parë bëhet në tufën e moshës 24-javëshe (+/- 2 javë), të tufës.

Kampionimi nga Shërbimi Veterinar Rajonal zbatohet për të paktën:

- a) një herë në vit për një tufë që përfshin të paktën 1000 zogj;
- b) në moshën 24-javëshe (+/- 2 javë) në tufat e pulave për prodhimtari vezësh të cilat janë të vendosura në njësi në të cilat shtamet përkatëse *Salmonella* janë zbuluar në ciklin paraardhës;
- c) në çdo rast dyshimi për infeksion salmonelar gjatë investigimeve të Shërbimit Veterinar Rajonal për toksiinfeksionet ushqimore ose në të gjitha rastet kur Shërbimi Veterinar Rajonal e gjykon të përshtatshme zbatimin e protokollit të marrjes së mostrave sipas pikës 4, shkronja “b”, të pjesës D, në shtojcën II, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”;
- ç) në të gjitha tufat e tjera të shpendëve të njësisë prodhuese në rastin e zbulimit edhe në një tufë të vetme të pranisë së *Salmonella Enteritidis* ose *Salmonella Typhimurium*;
- d) në rastet kur Shërbimi Veterinar Rajonal e konsideron të përshtatshme;
- dh) një kampionim i kryer nga Shërbimi Veterinar Rajonal mund të përsëritet me kërkesë të Operatorit të Biznesit të Ushqimit.

2.2 Protokollit i marrjes së mostrave

Për të rritur cilësinë e marrjes së mostrave dhe për të siguruar zbatimin e saktë të protokollit të marrjes së mostrave, Shërbimi Veterinar Rajonal ose Operatori i Biznesit (për qëllim autokontrolli) të sigurojë që mostrat të merren nga persona të trajnuar.

2.2.1 Kampionimi nga Operatori i Biznesit

Në tufat e mbajtura në kafaze, pas largimit të plehut (manureve) merren me anë të spatulave 2x 150 g feçe të depozituara natyralisht në shtresë, rasketa e rripave të impiantit të largimit të manureve, në rastin e kapanoneve pa impiant largimi të manureve merren 2x150 feçe të freskëta të mbledhura nga 60 pika të ndryshme poshtë kafazeve, në gropat e mbledhjes së plehut.

Në kapanonet me kafaze, në të cilat një sasi e mjaftueshme e plehut nuk grumbullohet në strukturat e sipërpërmendura, duhet të përdoren katër ose më shumë tamponë, me lecka të lagura, prej të paktën 900 cm², për të tamponuar një sipërfaqe sa më të gjerë që të jetë e mundur në ekstremitetet e shkarkimit të të gjithë zinxhirëve të aksesueshëm (të arritshëm), duke siguruar që çdo tampon të jetë i veshur nga të dyja anët me material fekal, që vjen nga rripat dhe nga rasketat ose nga pastruesit e rripave:

- a) në kapanonet me furrik ose me rritje të lirë të pulave për prodhimtari vezësh, duhen marrë kampione nga të dyja çizmet tamponuese apo veshjet njëpërdorimshe që mbathen për të lëvizur brenda pularisë.

Çizmet tamponuese të përdorura duhet të jenë prej një materiali absorbues për të thithur lagështinë. Sipërfaqja e çizmeve tamponuese apo veshjeve njëpërdorimshe, që mbathen nga veshja njëpërdorimshe e këmbëve, duhen zbutur (njomur) duke përdorur tretësirat e duhura.

Kampionet duhet të prelevohen, ndërsa lëvizjet nëpër pulari, duke përdorur një rrugëtim që rezulton në prodhimin e kampioneve përfaqësuese për të gjitha pjesët e pularisë ose sektorit përkatës. Kjo përfshin zonat e ndotura dhe ndarjeve midis kanaleve grumbulluese të feçeve, me kusht që këto të jenë të sigurta për të ecur dhe jo në zonat e jashtme të pularisë, në rastet kur pularitë janë me hyrje të jashtme. Të gjitha ndarjet kufizuese në brendësi të një pularie duhet të futen në kampionim. Me përfundimin e kampionimit në sektorin e zgjedhur, çizmet tamponuese duhet të hiqen me kujdes për të mos larguar materialin e ngjitur.

Në pularitë me shumë nivele ose në rritjet e lira, në të cilat pjesa më e madhe e materialit fekal hiqet nga stalla me rripa transportues të feçeve, duhet të merret një kampion nga veshjet

njëpërdorimshe të këmbëve, me tampon të lagur, nga të gjitha rripat transportues të feçeve, si në paragrafin e dytë të shkronjës “a”.

Të dy mostrat mund të bashkohen së bashku për të formuar një mostër për testim.

2.2.2 Kampionimi nga Shërbimi Veterinar Rajonal

Së paku, një mostër duhet të mblihdhet duke përdorur protokollin e marrjes së mostrave, në vijim të mostrave të përmendura në pikën 2.2.1. Mostra të mëtejshme do të merren për të siguruar marrjen e mostrave përfaqësuese nëse kërkohet, në varësi të shpërndarjes ose madhësisë së tufës.

Në rastin e marrjes së mostrave sipas pikës 2.1 “b”, “c”, “d” dhe “e”, Shërbimi Veterinar Rajonal vetësigurohet duke kryer kontrole të tjera me anën e testeve laboratorike dhe/ose kontrole dokumentacioni të vlefshme për të garantuar që rezultatet e ekzaminimeve për *Salmonella* në shpendë nuk ndikohen nga përdorimi i substancave antimikrobike në tufë.

Kur nuk zbulohet prania e *Salmonella Enteritidis* dhe *Salmonella Typhimurium*, por zbulohen substanca antimikrobike ose efekte frenuese të rritjes bakteriale, ato konsiderohen dhe llogariten si tufa të pulave për prodhimtari vezësh që konsiderohen si të infektuar për qëllim të përmbushjes së objektivave kombëtarë.

Shërbimi Veterinar Rajonal mund të vendosë të lejojë zëvendësimin e një kampioni fekal ose një tamponi të marrë nga çizmet tamponuese njëpërdorimshe të këmbëve me një mostër pluhuri prej 100 gramësh të mbledhur nga vende të shumta në të gjithë pularinë prej sipërfaqeve me një prani të dukshme pluhuri. Për të mbledhur pluhur nga sipërfaqe të shumta të shpendarisë, si alternativë, mund të përdoret një ose disa tamponë garze të lagur, të prelevuara nga një sipërfaqe totale prej të paktën 900 cm², duke u siguruar që tamponi të mbulohet nga pluhuri në të dyja anët e tij.

Struktura përgjegjëse për veterinarinë mund të vendosë të rrisë numrin minimal të kampioneve, në mënyrë që të sigurojë marrjen e mostrave përfaqësuese në një vlerësim rast pas rasti të parametrave epidemiologjikë, përkatësisht kushtet e biosigurisë, shpërndarjen, madhësinë e tufës ose kushteve të tjera përkatëse.

3. EKZAMINIMI I KAMPIONEVE

3.1 Transporti dhe përgatitja e kampioneve

Kampionet duhet të dërgohen brenda 24 orëve pas mbledhjes në laboratorët e përmendur në nenet 11 dhe 12, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”. Nëse nuk dërgohen brenda 24 orëve, ato duhet të ruhen në frigorifer. Mostrat mund të transportohen në temperaturën e ambientit me kusht që të shmanget nxehtësia e tepërt (përkatësisht mbi 25°C) ose ekspozimi ndaj dritës së diellit. Në laborator mostrat mbahen në frigorifer deri në ekzaminim, i cili duhet të fillohet brenda 48 orëve pas mbërritjes në laborator brenda 4 ditëve nga marrja e mostrës në tufë.

Në rastin kur marrja e mostrave kryhet nga Shërbimi Veterinar Rajonal përgatitja e mostrave bëhet e veçantë sipas llojit të tyre: veshje këmbësh njëpërdorimshe, çizme tamponuese, mostra pluhuri apo tamponë garze për pluhurin e sipërfaqeve të mëdha. Ndërsa kampionet e marra nga Operatori i Biznesit mostrat e tipave të ndryshëm mund të kombinohen brenda një testi.

3.1.1 Kampionet e marra nga veshjet njëpërdorimshe të këmbëve ose të tamponëve garzë të pluhurit:

a) dy çifte çizmesh të tamponëve të veshjeve njëpërdorimshe të këmbëve ose tamponët e pluhurit, duhet të shpaketohen me kujdes, për të evituar shpërndarjen e materialit fekal të ngjitur, të grumbulluar dhe të ruajtur në ujë peptonik të buferuar (UPB), që është ngrohur paraprakisht në temperaturë mjedisi, ose duke shtuar direkt 225 ml tretës në dy çiftet e veshjeve njëpërdorimshe të këmbëve, në kontenitorin e tyre, me të cilën kanë mbërritur në laborator. Veshjet njëpërdorimshe të këmbëve ose kampionet e tamponëve të pluhurit duhet të zhyten komplet në ujë peptonik të

buferuar (UPB), për të siguruar lëng të mjaftueshëm të lirë rreth kampionit për migrimin e salmonelave nga kampioni dhe për këtë arsye, nëse është e nevojshme mund të shtohet më shumë ujë peptonik të buferuar (UPB);

b) mostra duhet të tundet për ta ngopur plotësisht atë dhe mbjellja të vijojë duke përdorur metodën e zbulimit të përcaktuar në pikën 3.2.

3.1.2 Materialet e tjera fekale dhe të pluhurit:

a) mostrat e feçeve duhet të grumbullohen dhe përzihen me kujdes dhe një nënmostër prej 25 gramësh mbledhet për kulturën;

b) nënkampionit me 25 gramë (ose 50 ml suspension që përmban 25 gramë të kampionit fillestar) i shtohet 225 ml UPB, i cili është ngrohur paraprakisht në temperaturën e dhomës;

c) mbjellja e kampionit vijon duke përdorur metodën e zbulimit të përcaktuar në pikën 3.2.

Nëse për përgatitjen e kampionëve përkatës për zbulimin e specieve *Salmonella* janë miratuar standardet ISO, ato do të zbatohen dhe do të zëvendësojnë ato të përcaktuara në pikat 3.1.1 dhe 3.1.2.

3.2 Metoda e zbulimit

Zbulimi i *Salmonella spp.* do të kryhet sipas EN ISO 6579-1. Pas inkubacionit, kampionet në UPB nuk duhet të tunden, përzihen, as të tronditen ose të tunden në mënyra të ndryshme.

3.3 Serotipizimi

Së paku një izolat nga secili kampion pozitiv i prelevuar nga Shërbimi Veterinar Rajonal duhet të serotipizohet, sipas skemës *Kaufmann-White-LeMinor*. Në izolatet e prelevuara nga operatorët e biznesit, duhet të paktën të kryhet serotipizimi për *Salmonella Enteritidis* dhe *Salmonella Typhimurium*.

3.4 Metodat alternative

Për zbulimin dhe serotipizimin e parashikuar në pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të kësaj shtojce, mund të përdoren metodat alternative në vend të metodave të zbulimit, nëse vërtetohen që janë të njehsuara me EN ISO 16140-2 (për metodat alternative të zbulimit).

3.5 Testimi i rezistencës antimikrobike

Izolantët të testohen për rezistencën antimikrobike sipas legjislacionit në fuqi.

3.6 Ruajtja e shtameve

Shërbimi Veterinar Rajonal siguron çdo vit që të paktën një shtam të izoluar të serotipave më me rëndësi të serotipave të *Salmonella*, nga marrja e mostrave si pjesë e kontroleve zyrtare për çdo pulari, të ruhet për testime të mundshme të fagotipizimit ose të ndjeshmërisë antimikrobike, duke përdorur metodat normale për mbledhjen e kulturës, të cilat duhet të sigurojnë integritetin e shtameve për një periudhë minimale 2-vjeçare.

Shërbimi Veterinar Rajonal vendos nëse izolatet nga marrja e mostrave nga operatorët e biznesit të ushqimit, gjithashtu, duhet të ruhen për këto qëllime.

4. REZULTATET DHE RAPORTIMI

4.1 Një tufë e pulave për prodhimtari vezësh konsiderohet pozitive, kur:

a) prania e serotipave më me rëndësi e *Salmonella* përkatës (përveç atyre të vaksinës) është zbuluar në një ose më shumë mostra të marra në tufat, edhe nëse serotipi *Salmonella* zbulohet vetëm në kampionin e pluhurit ose tamponin e pluhurit; ose

b) janë zbuluar në tufë substanca antimikrobike ose frenues të rritjes bakteriale.

Ky rregull nuk do të zbatohet në raste të jashtëzakonshme të përshkruara në shtojcën II D, pika 4 në urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”, kur rezultati fillestar *Salmonella* pozitiv nuk është konfirmuar nga protokoli përkatës i marrjes së mostrave.

4.1.1 Një tufë pulash për prodhimtari vezësh konsiderohet vetëm një herë pozitive, pavarësisht nga:

- a) sa shpesh është zbuluar serotipi *Salmonella* në këtë tufë gjatë periudhës së prodhimit; ose
- b) pavarësisht nëse marrja e mostrave është bërë me kërkesën e Operatorit të Biznesit të ushqimit apo nga Shërbimi Veterinar Rajonal.

Sidoqoftë, nëse marrja e mostrave gjatë periudhës së prodhimit është shpërndarë në 2 vite kalendarike, rezultati i secilit vit raportohet veçmas.

4.2 Raportimi përfshin:

a) numrin e përgjithshëm të tufave të pulave për prodhimtari vezësh, të cilat janë testuar të paktën një herë gjatë vitit të raportimit;

b) rezultatet e testimit përfshijnë:

i. numrin e përgjithshëm të tufave pozitive të pulave për prodhimtari vezësh në të gjithë territorin e vendit;

ii. numrin e tufave pozitive të pulave për prodhimtari vezësh, të paktën një herë, me *Salmonella Enteritidis* dhe *Salmonella Typhimurium*;

iii. numrin e tufave pozitive të pulave për prodhimtari vezësh për secilin serotip *Salmonella* ose për *Salmonella* të paspecifikuara (izolatet që janë të patipizuara ose të paserotipizuara).

Shpjegimet e rezultateve, veçanërisht, në lidhje me raste të jashtëzakonshme ose çdo ndryshim thelbësor në numrin e tufave të testuara dhe/ose të gjetura pozitive.